



Funded by  
the European Union



MODELI KOLEGIAL I SIGURIMIT TË CILËSISË NË KOSOVË

# UDHËZUES PRAKTIK PËR VËZHGIM EFEKTIV TË ORËS MËSIMORE

Projekti "Përkrahje për arsimin fillor dhe të mesëm të lartë"



# Hyrje

Ky udhëzues është hartuar për të ndihmuar profesionistët arsimorë të vëzhgojnë në mënyrë efektive orët mësimore.

Këshillat në këtë udhëzues janë të bazuara në hulumtime akademike të dëshmuara. Por, meqenëse ky është një udhëzues praktik, nuk do të citohen burimet akademike.

Bibliografia në fund të udhëzuesit përmban burimet akademike të cilat përforcojnë këshillat në këtë udhëzues.



# Fjalorthi

**Shënrimi mirënjohës** është kur mësimitdhënësi përdor shenjën  $\checkmark$ , shenja të thjeshta apo përmirësime (10/10), vulën dhe/ose komente të shkurta të bazuara në arritje.

**Përmbajtje e diferencuar** do të thotë përdorimi i formave të ndryshme të mësimitdhënies si video, tekste, ligjërimi apo audio.

**Diferencimi përmes produktit** do të thotë që mësimitdhënësit vlerësojnë njohurinë apo shkathtësinë e njëjtë për secilin nxënës por u ofrojnë nxënësve një varg mënyrash për ta demonstruar dijen e tyre (p.sh., video, raport me shkrim).

**Diferencimi përmes procesit**, do të thotë që mësimitdhënësit ua mësojnë konceptin apo shkathtësinë e njëjtë secilit nxënës por ndryshon mënyra e mësimitdhënies. Nxënësit mund të punojnë në çifte apo grupe, mund të përdorin teknologjinë apo objekte për t'u ndihmuar në kuptimin e konceptit.

**Diferencimi i mjedisit të mësimit** do të thotë që mësimitdhënësi bën ndryshime ose në mjedisin fizik apo në ambientin në të cilin punojnë nxënësit.

**Informata kthyese** mund të jenë në formë të shkruar ose me gojë. Është informatë të cilën mësimitdhënësi ia jep nxënësit lidhur me performancën e tij (Notimi i nxënësit, p.sh., 1, 2, 3, 4, 5 nuk është informatë kthyese)

**Vlerësimi formativ**: përdoret për të informuar procesin e mësimitdhënies dhe nxënies. Ai identifikon keqkuptimet dhe boshllëqet në nxënie dhe e përmirëson mësimitdhënies dhe nxënies. *Për shembull: kuizet, reflektimet në klasë, përdorimi i pyetjeve të hapura, sondazhe, punë në grupe me detyra më të rëndomta.*

**Vlerësimi formativ afatgjatë**: Arritja e nxënësit monitorohet përgjatë njësive mësimore. Cikli i vlerësimit mund të jetë nga 4 javë deri në 1 vit. Të dhënat përdoren për të bashkërenduar planprogramin, për të monitoruar mësimitdhënien e planprogramit dhe arritjet e nxënësve brenda një periudhe të gjatë kohore. *Për shembull: vlerësimi në fund të gjysmë vjetorit, vlerësimi në fund të vitit shkollor.*

**Vlerësimi formativ afatmesëm**: bëhet në fund të një faze të mësimit-nxënies. Ky vlerësim bëhet çdo 1 deri në 4 javë. *Për shembull: vlerësimi i një pjese të shkruar që është kulminacioni i punës trejavore. Një test në matematikë pas dy javë mësimit të thyesave.*

# Fjalorthi

**Vlerësimi formativ afatshkurtë:** një tjetër fjalë për këtë është 'mësimdhënia reaguese'. Ky vlerësim bëhet brenda dhe ndërmjet orëve mësimore. Mësimdhënësi reagon ndaj të dhënave të mbledhura dhe mësimdhënien e përshtat në përputhje me këto të dhëna. *Për shembull: pyetjet e hapura, vëzhgimi i mësimdhënësit, kuizet, dhënia individuale e përgjigjeve në tabelë të bardhë ose në letër.*

**Pyetja e hapur** është mënyrë kyçe e kontrollimit të të kuptuarit në një moment të njësisë e cila është tejet e rëndësishme që nxënësit ta kuptojnë. Çdo nxënës duhet t'i përgjigjet pyetjes brenda dy minutave. Mësimdhënësi duhet të jetë në gjendje të mbledhë dhe interpretojë përgjigjet nga të gjithë nxënësit brenda 30 sekondave dhe të vendosë se si të vazhdojë tutje më mësimin.

**Metakognicioni** ka të bëjë me mënyrat se si nxënësit monitorojnë dhe qëllimshëm drejtojnë nxënien e tyre.

**Vlerësimi nga shoku/shoqja** ndodh kur nxënësit marrin përgjegjësinë për të vlerësuar punën e shokut/shoqes së tyre kundrejt kriterëve të përcaktuar.

**Mësimdhënia reaguese:** është një mënyrë tjetër e të thënit vlerësimi formativ afatshkurtër.

**Rubrika** është një udhëzues për vlerësimin e performancës, të një produkti apo projekti. Ajo zakonisht përmban kriteret e performancës; dhe shkallën e notimit (shkëlqyeshëm, mirë, kënaqshëm, jo kënaqshëm ose 1, 2, 3, 4, 5 ose A, B, C, D, E)

5	4	3	2	1
Tregoi të kuptuar të thellë të detyrës	Tregoi të kuptuar gjithëpërfshirës të detyrës	Tregoi të kuptuar bazik të detyrës	Tregoi të kuptuar të kufizuar të detyrës	Nuk e kuptoi detyrën.

**Vetëvlerësimi:** është kur nxënësit vlerësojnë vetveten. Mund t'i vlerësojnë veprimet e tyre, qëndrimet apo performancën e tyre.

**Nxënësit e vetorganizuar:** kuptojnë dhe kontrollojnë mjedisin e tyre të nxënies.

Aftësitë e vetorganizimit përfshijnë vënien e qëllimeve, vetëmonitorimin dhe vetudhëzimin.

**Këshilli i nxënësve:** është grupi i nxënësve të zgjedhur nga moshatarët e tyre për të adresuar shqetësimet e tyre.

**Kriteret e suksesit:** është një listë e tipareve të cilat mësimitdhënësi dëshiron që nxënësit e tyre t'i përfshijnë në punën e tyre gjatë një ore mësimore.

## Performancë e shquar profesionale

	E shquar
Planifikimi	<p>Objektivat e njësisë mësimore janë të qarta dhe në lidhje me temën.</p> <p>Plani dëshmon qartë nxënien e individualizuar përmes përdorimit të aktiviteteve, diferencimit dhe strategjive të vlerësimit.</p> <p>Burimet e propozuara përshtaten qartë me objektivat e njësisë mësimore.</p> <p>Nxënësit nxiten në mënyrë të duhur.</p>
Njohuria e lëndës	<p>Njohuri e shkëlqyer e lëndës. Mësimdhënësi përshtatë njohuritë akademike për moshën dhe aftësitë e nxënësve. Mësimdhënësi lidh me shkathtësi lëndën me situata praktike të jetës reale.</p>
Sjellja dhe qëndrimi i nxënësve ndaj nxënies	<p>Nivel i lartë i angazhimit, mirësjellje dhe bashkëpunim ndërmjet të gjithë nxënësve. Ekziston një klimë produktive për nxënie në të cilën nxënësit ndihen të vlerësuar dhe të sigurtë.</p>
	<p>Mësimi zhvillohet pa ndërprerje. Strategjitë e menaxhimit të sjelljes kontribuojnë të jetë një klimë e vazhdueshme pozitive për nxënie. Qëndrimi i nxënësve ndaj nxënies së tyre dhe ndaj nxënies së tjerëve është shembullore.</p>



# Performancë e shquar profesionale

	E shquar
Vlerësimi formativ dhe informata kthyese	Nxënia e mëparshme vlerësohet në mënyrë të saktë përmes vlerësimeve diagnostikuese siç është pyetjet me shumë zgjedhje dhe vlerësime tjera formative afatshkurta. Vlerësimet diagnostikuese përdoren në mënyrë të duhur. Mësimdhënësi reagon në mënyrë efektive në vlerësimet diagnostikuese brenda orës mësimore dhe e përshtat njësinë mësimore në përputhje me to.
Strategjitë e mësimdhënies	Ora mësimore përfshinë strategji imagjinate të cilat sfidojnë nxënësit. Ato nxisin të menduarit kritik dhe kreativitetin. Strategjitë e mësimdhënies individualizojnë nxënien përmes diferencimit të përmbajtjes së procesit, produktit dhe të mjedisit të nxënies.
	Të pyeturit në mënyrë sistematike nxitë të kuptuarit, identifikon keqkuptimet dhe parashikon ndërhyrjet. Reagimi i mësimdhënësit ndaj të pyeturit ka ndikim të konsiderueshëm në të nxënit e nxënësve.
	Mësimdhënësi menaxhon shkëlqyeshëm orën mësimore. Shpejtësia përdoret në mënyrë të duhur për zgjerimin e njohurive në mënyrë të duhur dhe për të sfiduar nxënësit.
Përparimi i të nxënit	Të gjithë nxënësit shfaqin shkallë të lartë të entuziazmit dhe interesimit. Kanë vetëbesim dhe janë të angazhuar në orën mësimore. Nxënësit udhëheqin të nxënit dhe kuptojnë hapat e radhës në procesin e të mësuarit.

## Performancë jo e kënaqshme profesionale

	Jo kënaqshëm
Planifikimi	Planifikimi dhe përgatitja është jo adekuate, e paqartë ose mungon fare.
Njohuria e lëndës	Njohuri e kufizuar e lëndës. Ose, njohuria e lëndës është jo e duhur për moshën dhe aftësitë e nxënësve. Mësimdhënësi bën gabime të shpeshta lidhur me përmbajtjen e lëndës e cila mësohet.
Sjellja dhe qëndrimi i nxënësve ndaj nxënies	Nuk ka dëshmi për të demonstruar ekzistimin e një klime pozitive e të nxënit.
Vlerësimi formativ dhe informata kthye	Vlerësimi merr pak për bazë të nxënit e mëparshëm. Nuk ka dëshmi të vlerësimit formativ diagnostikues siç është pyetjet me shumë zgjedhje brenda orës mësimore. Mësimdhënësi nuk bën asnjë përshtatje të mësimdhënies dhe të nxënit.
	Nxënësve u jepet nota 1, 2, 3, 4, 5 pa asnjë informatë kthye me shkrim apo me gojë.
	Nxënësit nuk bëjnë vetëvlerësim të punës së tyre. Atyre u jepet nota 1, 2, 3, 4, 5 pas asnjë koment.

## Performancë jo e kënaqshme profesionale

	Jo kënaqshëm
Strategjitë e mësimdhënies	Nuk ka dëshmi për objektiva apo diferencim të të nxënit. Të gjithë nxënësit bëjnë detyrën e njëjtë në të njëjtën kohë dhe shpejtësi. Aktivitetet nuk përmbushin nevojat e nxënësve individual.
	Mësimdhënia karakterizohet me pyetje të mbyllura ndaj disa nxënësve. Nuk përdoren pyetjet e vlerësimit diagnostikues/formativ.
	Orës mësimore i mungon ritmi dhe rezultatet për shkak të angazhimit të vogël të nxënësve. Nxënësit duket se bëjnë të njëjtën detyrë me ritmin e njëjtë.
	Vlerësimi merr pak për bazë të nxënit e mëparshëm. Nuk ka dëshmi të vlerësimit formativ diagnostikues siç është pyetjet me shumë zgjedhje brenda orës mësimore. Mësimdhënësi nuk bën asnjë përshtatje të mësimdhënies dhe të nxënit.
Përparimi i të nxënit	Nxënësit janë pasiv. Mësimdhënia nuk arrin të angazhojë, entuziazmojë apo motivojë nxënësit.

## Vëzhgimet joformale

Vëzhgimet joformale janë shpeshherë vizita të shkurta, të paparalajmëruara, në klasë prej 10 deri 15 minuta.

Ato mund të jenë edhe vëzhgime të tërë orës mësimore që bëhen nga kolegët për të ofruar **mbështetje** dhe **udhëzim**.

## Vëzhgimet formale

Vëzhgimet formale zakonisht bëhen nga anëtarët e ekipit menaxhues i shkollës. Ato gjithmonë aranzhohen paraprakisht dhe zakonisht përfshijnë takime para dhe pas vëzhgimit.

Vëzhgimet formale përdoren si pjesë e *procesit të vlerësimit* dhe janë të projektuara për të siguruar *llogaridhënien* e personelit.

# Qëllimi i vëzhgimit joformal mbështetës në orën mësimore

Qëllimi i vëzhgimit joformal mbështetës në orën mësimore është:

1. Të zhvillojë, mentorojë dhe udhëzojë mesimdhënësit t'i përmirësojnë shkathtësitë e tyre.
2. Të ndajnë përvojën efektive profesionale ndërmjet pjesëtarëve individual të personelit dhe departamenteve.
3. Të zhvillojë qasje inovative ndaj mesimdhënies.
4. Të bëjë vëzhgimin e nxënësve individual apo grupeve të nxënësve në mbështetje të mesimdhënësve.

Vëzhgimet joformale në orë mësimore nuk duhet të jenë gjykuese apo të jenë pjesë e procesit të vlerësimit formal.

## Praktikat më të mira të vëzhgimit joformal të orës mësimore

1. Shkollat duhet të kenë 'politika e derës së hapur' në të cilën vëzhgimi joformal mbështetës dhe konstruktiv është i mishëruar në kulturën e shkollës.
2. Të gjithë anëtarët e personelit duhet ta kenë mundësinë të 'futen' në orën mësimore të kolegut.
3. Vëzhgimi joformal i orës mësimore duhet të përdoret si masë përcjellëse pas seminareve të zhvillimit profesional. Ato mund të ndihmojnë që shkollat ta vlerësojnë efektshmërinë e seminareve.
4. Vlerësimet joformale duhet të përdoren si bazë për trajnimin e mësimit. Trajnimi efektiv ndërmjet kolegëve ndodhë vetëm atëherë kur orët mësimore vëzhgohen.
5. Vëzhgimet joformale duhet të përdoren për të vlerësuar performancën e përgjithshme në shkollë dhe të ofrojnë të dhëna për vetëvlerësimin e shkollës.
6. Vetëvlerësimi efektiv për mësimit dhe nxënie mund të shkruhet vetëm pas vëzhgimeve të shumta joformale të orëve mësimore brenda shkollës.

## Qëllimi i vëzhgimit formal të orëve mësimore

Vëzhgimet formale mund të përdoren në të njëjtën mënyrë si vëzhgimet jo formale.

Vëzhgimet formale mund të përdoren për:

1. Të zhvilluar, mentoruar dhe trajnuar mësimdhënësit në përmirësimin e shkathtësive të tyre.
2. Të ndarë përvojat efektive profesionale ndërmjet anëtarëve individual të personelit dhe aktiveve.
3. Të zhvilluar qasje inovative ndaj mësimdhënies.
4. Të bërë vëzhgime të nxënësve individual apo grupeve të nxënësve në mbështetje të mësimdhënësve për të përshtatur praktikën e tyre profesionale.

Sidoqoftë, vëzhgimet formale përdoren edhe për të siguruar **llogaridhënien** e personelit. Ato përdoren si pjesë e procesit formal të vlerësimit.

Si rezultat i kësaj, ato nuk janë po aq efektive sa vëzhgimet jo formale në mbledhjen e të dhënave të sakta lidhur me cilësinë e mësimdhënies dhe nxënies së përditshme në shkollë.

## Praktika më e mirë e vëzhgimit formal të orës mësimore

1. Shkollat **nuk** duhet të mbështeten në vëzhgimet formale për të vlerësuar cilësinë e përditshme të mësimdhënies dhe nxënies.
2. Është e rëndësishme që shkollat ta kenë politikën 'dera e hapur' në të cilën vëzhgimi jo formal mbështetës dhe konstruktiv është i mishëruar në kulturën e shkollës.
3. Ndonëse modelet me nota të vëzhgimit të orës mësimore janë të dobishme për vlerësimin e praktikës profesionale, është e rëndësishme që mësimdhënësit të mos vlerësohen **pa informatë kthyese** se si mund të përmirësohen.
4. Ndonëse modelet me nota të vëzhgimit të orës mësimore janë të dobishme për vlerësimin e praktikës profesionale, disa menaxherë mund të ndiejnë se etiketimi i mësimdhënësit me një notë mund të jetë kundërproduktiv. Këshillimi profesional i tyre është më i rëndësishëm.



# Teknikat e vëzhgimit të orës mësimore

## Ku të uleni

Vëzhguesi duhet të ulet diku në klasë ku nuk e pengon shumë orën mësimore.

## Vëzhgoni nxënien, jo mësimdhënien

Vëzhguesi duhet të mbajë shënime lidhur me nxënien, jo mësimdhënien.

Me rëndësi është të kuptohet se edhe në qoftë se njësia mësimore paraqitet me shkathtësi, kjo nuk do të thotë që nxënësit mësojnë ndonjë gjë.

Vëzhguesi duhet të identifikojë:

- shkallën e angazhimit të nxënësve
- shkallën e vështirësisë për nxënës
- ndikimin e njësisë mësimore në të mësuar.

## Mbajtja e shënimeve

Në qoftë se vëzhguesi vëzhgon tërë apo gjysmën e orës mësimore, vëzhguesi duhet të shkruaj sa më shumë detaje që është e mundur për atë se çfarë bëjnë nxënësit në momente të caktuara të orës mësimore.

Është me rëndësi të shënohet koha dhe vëzhgimi. Nëse është e mundur, shkruani edhe emrin e nxënësit në shënime, gjithashtu.

Për shembull:

**10 min:** Të gjithë nxënësit janë të angazhuar në prezantim.

**25 min:** 1 grup i nxënësve nuk është aktiv sepse nuk i kanë kuptuar udhëzimet.

**40 min:** Albana përfundoi punën dhe kërkonte vazhdimin e aktivitetit pa u kërkuar kjo gjë nga mësimdhënësi.

### Shënimet e vëzhgimit jo formal

Në qoftë se vëzhguesi kryen një varg të vëzhgimeve jo formale, më mirë është të shkruaj shënimet pasi të jenë larguar nga klasa për siguruar krijimin e kulturës mbështetëse të vëzhgimit jo formal në shkollë.

### Biseda me nxënës

Vëzhguesi duhet të provojë të bisedojë me nxënës në mënyrë të qetë dhe t'i pyes ata se çfarë po mësojnë (Por, vëzhguesi nuk duhet ta pengojë zhvillimin e mësimit).

Për shembull:

- Çfarë po mësoni sot?  
*(Për të kontrolluar që nxënësit i kanë kuptuar objektivat e orës mësimore)*
- Çka duhet të bëni?  
*(Të kontrollojë nëse nxënësit i kanë kuptuar udhëzimet)*
- Sa sfiduese është kjo punë për ju?  
*(Të kontrollojë nëse të mësuarit është i individualizuar)*

Vëzhguesi duhet të përqendrohet më shumë në vëzhgim se në bisedë, por duhet gjithashtu të reagojë në mënyrë të ndjeshme sipas mjedisit specifik të klasës dhe të veprojë në përputhje me atë.

# Fokusi i vëzhgimit të orës mësimore

Të gjitha vëzhgimet e orës mësimore duhet të fokusohen fillimisht në fushat kryesore pedagogjike.

- **Vlerësimi dhe informata kthyese**
  - Vëzhguesi duhet të kërkojë dëshmi të strategjive reaguese mësimdhënëse siç është *pyetja me shumë zgjedhje*, apo përdorimi i tabelave të bardha individuale për të dhënë përgjigje në *vlerësimet diagnostikuese*.
  - Si rezultat i këtij *vlerësimi formativ afatshkurtër* përmbajtja e orës mësimore duhet të përshtatet në kohë reale për të përmbushur më mirë nevojat e nxënësve individual.
  - Vëzhguesi duhet të kërkojë dëshmi në libra që vetëvlerësimi i nxënësve është **sistematik**.
  - Mësimdhënësit nuk duhet asnjëherë t'i japin nxënësve nota **1, 2, 3, 4, 5** pa **komente me shkrim ose me gojë** lidhur me atë se çka kanë bërë dhe çka duhet të bëjnë për t'u përmirësuar.
  - Vëzhguesi duhet të kërkojë dëshmi se janë përdorur rubrika që vlerësimin me notë ta bëjnë më transparent në mes nxënësit dhe mësimdhënësit.

- **Planifikimi**

Vëzhguesi duhet të analizojë planet mësimore të mësimdhënëseve.

Planet mësimore nuk duhet të jenë shumë të detajuar, por duhet të përmbajnë:

- **Objektiven e qartë të nxënies dhe kriteret e suksesit.**
- **Një larmi të strategjive pedagogjike**
- **Strategji të vlerësimit formativ afatshkurtër.** (p.sh. Pyetjet me shumë zgjedhje, vlerësime diagnostikuese, përdorimi i mini tabelave të bardha, etj.)
- **Të mësuarit e individualizuar.** Njësitë mësimore diferencohen në bazë të përmbajtjes, procesit, produktit dhe/ose mjedisit të nxënies.
- **Sfida.** Mësimdhënësit duhet të përpiqen të planifikojnë një sfidë për nxënësit në çdo orë mësimore.

Planet duhet të jenë dëshmi e realitetit se çka mësohet në klasë.

Është thelbësore që vëzhguesi të krahasojë planifikimin kundrejt zhvillimit të njësisë mësimore.

Praktikë e mirë është që mësimdhënësi t'i ndryshojë elementet e planifikimit duke u bazuar në **strategjitë e mësimdhënies reaguese** siç janë pyetjet me shumë zgjedhje dhe të tjerat në vlerësimet diagnostikuese të orës mësimore.

- **Strategjitë e mësimdhënies**

- Gjatë vëzhgimit të orës mësimore, vëzhguesi duhet të kërkojë **strategjitë aktive dhe bashkëpunuese të nxënies** që janë të lidhura me objektivat e njësisë mësimore.
- Vëzhguesi duhet të kërkojë dëshmi të **kritereve të suksesit ose rubrikave** të cilat i përdorin nxënësit.
- Vëzhguesi duhet të kërkojë dëshmi që nxënësve u janë dhënë mundësi që ta regjistrojnë dhe prezantojnë të mësuarit e tyre në mënyra të ndryshme.
- Vëzhguesi duhet të kërkojë dëshmi që nxënia është e **individualizuar** sa më shumë të jetë e mundur. Nxënia duhet të jetë e diferencuar përmes kombinimit të përmbajtjes, procesit, produktit dhe mjedisit të nxënies.
- Vëzhguesi duhet të kërkojë dëshmi që mësimdhënësi përdorë një varg të **teknikave të të pyeturit**, jo vetëm pyetje të mbyllura: pyetje të hapura, pyetje nxitëse, pyetje për vlerësimin e të nxënit.
- Vëzhguesi duhet të kërkojë dëshmi që **vetëvlerësimi dhe reflektimi** i nxënësve është pjesë sistematike i praktikës profesionale të mësimdhënësit.
- Vëzhguesi duhet të kërkojë dëshmi që mësimdhënësi ka **njohuritë e nevojshme të lëndës** për të dhënë mësim në mënyrë efektive.

- **Menaxhimi i sjelljes**

Vëzhguesi i orës mësimore duhet të vlerësojë nivelin e angazhimit të nxënësve dhe bashkëpunimin ndërmjet të gjithë nxënësve.

Vëzhguesi duhet të vlerësojë klimën për të nxënë dhe të shënojë të gjitha pengimet e të nxënit.

Vëzhguesi duhet të vëzhgojë strategjitë pozitive të menaxhimit të sjelljes, siç janë:

- **Lavdërimi specifik për sjellje pozitive:** Më pëlqen se si ti...
- **Sinjale të heshtura:** gjeste me dorë, shprehjet në fytyrë, etj.
- **Korrigjime të qeta:** Të mos turpërohen nxënësit duke i korrigjuar ata publikisht.
- **Sinjalizimi i sjelljes së pritshme:** ndarja e shpeshtë e pritshmërive të qarta për sjelljen.
- **Vendosja e rutinave të qarta:** Nxënësit e dinë çdoherë se çka duhet të bëjnë në fillim të orës mësimore apo nëse kanë mbaruar detyrat e tyre.

Nuk humbë koha e orës mësimore përmes mosaktivitetit.

# Informatat kthyese të vëzhgimit të orës mësimore

- **Informatat kthyese jo formale të orës mësimore**

Vëzhguesi i orës mësimore mund të mos jap komente individuale nga një varg i vëzhgimeve të shkurta të orëve mësimore.

Vëzhgimet jo formale të orës mësimore nuk kanë nevojë çdoherë për informatë kthyese sepse shpeshherë janë ushtrime për mbledhjen e informatave.

- **Vlerësimi i zhvillimit profesional të mësimitdhënësit**

Në qoftë se vëzhgimet jo formale të orës mësimore përdoren për të vlerësuar efektshmërinë e një seminari të zhvillimit profesional të mësimitdhënësit, atëherë vëzhguesi duhet të ndajë një email të përgjithshëm apo të zhvillojë një prezantim të përgjithshëm lidhur me atë që ka parë në ato orë mësimore.

Me rëndësi është që këto informata kthyese të mos jenë gjykuese dhe të mos kritikojnë mësimitdhënësin individual.

- **Informatat kthyese të vlerësimit formal të orës mësimore**

Nëse vëzhguesi është duke trajnuar mësimitdhënësin ose duke zhvilluar vëzhgim formal, vëzhguesi duhet të përdorë shembuj specifik se çka i kanë parë nxënësit të bëjnë gjatë orës së vëzhguar mësimore.

Për shembull:

**Vëzhgim specifik:**

Kur e bëre shenjën për heshtje duke vënë gishtin në gojë, e tërë klasa ndaloi së foluri.

**Vëzhgim specifik:**

Ju bëtë një pyetje të mbyllur dhe 4 nxënës ngritën dorën lartë.

**Vëzhgim specifik:**

Në minutën 15 e pasë që Arianiti dhe Liridoni nuk ishin të angazhuar në mësim dhe po bisedonin me njëri-tjetrin.

- **Teknikat e pyetjes**

Vëzhguesi duhet t'i bëjë pyetje mësimdhënësit për të nxjerrë se çfarë do të mund të ishte bërë ndryshe.

Vëzhguesi duhet të përdorë pyetje për ta drejtuar mësimdhënësin të nxjerrë vet konkluzionet e tij lidhur me atë se çka do të mund të kishin bërë ndryshe.

Për shembull:

**Vëzhgim specifik:**

Në prezantimin tuaj, ju i pyetët nxënësit Çka.... ? dhe 4 nxënës ngritën duart e tyre.

**Pyetje për mësimdhënësin:**

Si do të kishin mundur të angazhoni më shumë nxënës të klasës?

**Përgjigje:**

Do të mund ta përdornit strategjinë **Mendo / Qifte / Ndajë**. Së pari shtroni pyetjen. Pastaj u thoni nxënësve të flasin së pari me partnerin e tyre. Pastaj kërko nga ta që ta ngrenë dorën lartë për t'ia thënë përgjigjen tërë klasës.

- **Përdor dëshmi, jo mendimin**

Vëzhguesi nuk duhet të japë mendimin pa dëshmi apo të japë këshilla në veten e parë. Vëzhguesi duhet ta bazojë këshillën e tij në praktika të dëshmuara pedagogjike.

Për shembull:

**Vëzhgim specifik:**

Gjatë prezantimit tuaj, ju i pyetët nxënësit Çka... ? dhe 4 nxënës ngritën duart lartë.

**Mos thuaj:**

*"unë do ta kisha përdorur strategjinë mendo/qifte/ndajë me nxënësit e mi" .....*

**Thuaj:**

*" Është praktikë e mirë të përdoret strategjia mendo/qifte/ndajë me nxënës."*

## Bibliografia

**Centre for Teaching Excellence. (2019).** Rubrics: Useful Assessment Tools | Centre for Teaching Excellence. [online] Available at: <https://uwaterloo.ca/centre-for-teaching-excellence/teaching-resources/teaching-tips/assessing-student-work/grading-and-feedback/rubrics-useful-assessment-tools>.

**Cornell University (2019).** Using Rubrics | Center for Teaching Innovation. [online] Cornell.edu. Available at: <https://teaching.cornell.edu/teaching-resources/assessment-evaluation/using-rubrics>.

**Education Endowment Foundation (n.d.).** Teaching and Learning Toolkit. [online] EEF. Available at: <https://educationendowmentfoundation.org.uk/education-evidence/teaching-learning-toolkit>.

**EEF. (n.d.).** Written marking. [online] Available at: <https://educationendowmentfoundation.org.uk/education-evidence/evidence-reviews/written-marking>.

**Education Endowment Foundation (2021).** Feedback. [online] EEF. Available at: <https://educationendowmentfoundation.org.uk/education-evidence/teaching-learning-toolkit/feedback>.

**Effective classroom observation in primary and secondary schools. (2014).** [online] Available at: <https://www.estyn.gov.wales/system/files/2020-07/Effective%20classroom%20observation%20in%20primary%20and%20secondary%20schools%20-%20October%202014.pdf> [Accessed 27 Jun. 2022].

**Hattie, J. (2010).** Visible learning for teachers: Maximizing impact on learning. Routledge, Milton Park, UK.

Ho, A. and Kane, T. (n.d.). The Reliability of Classroom Observations by School Personnel. [online] Available at: <https://files.eric.ed.gov/fulltext/ED540957.pdf> [Accessed 27 Jun. 2022].

Prince, M. (2004). Does Active Learning Work? A Review of the Research. *Journal of Engineering Education*, 93, 223-231

Tomlinson, C. A. (2014) *The Differentiated Classroom: Responding to the Needs of All Learners*, 2nd Edition

William, D; Thompson, M; (2008) *Integrating Assessment with Learning: What Will It Take to Make It Work?* In: Dwyer, CA, (ed.)

*The Future of Assessment: Shaping Teaching and Learning.* (pp. 53-82).  
Routledge: New York, NY, USA

William, D (2011) *Embedded Formative Assessment.* Solution Tree Press

William, D. and Leahy, S. (2015). *Embedding formative assessment: practical techniques for K-12 classrooms.* West Palm Beach, Florida: Learning Sciences.

[www.sec-ed.co.uk](https://www.sec-ed.co.uk). (n.d.). Teaching practice: Hinge questions. [online] Available at: <https://www.sec-ed.co.uk/best-practice/teaching-practice-hinge-questions>.







Kosovo Legal  
Services Company



IBE



EDUCATIONAL  
RESEARCH  
INSTITUTE

Ky publikim është prodhuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi vetëm e Projektit KosEd dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.